



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 54/16

Prishtinë, më 27.4.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontiq, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri dhe Bardhyl Meta.

Munguan: Fikrim Damka, Ilir Deda, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi, zëvendësministër i Financave, Salvador Elmazi, drejtor i Buxhetit në MF, Dritan Gjonbalaj, drejtor në AAC, Shqipe Selishta, zyrtare kryesore e Financiare në AAC, Bekim Gimolli, kryesues-ANJF, Ramadan Gashi, drejtor në ANJF, Idriz Blakaj, drejtor i AMKMK-së, Albana Hajrizi- Kuneshevci, zyrtare kryesore e Financave në AMKMK, Adnan Elshani, drejtor AMKMK, Ruzhdi Jashari, mbikëqyrës kryesor Shtetëror, Bujar Sadiku, drejtor i Përgjithshëm në ASHMDHP.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Luminije Murati, nga Zyra e Presidentit, Fjolla Uka, monitoruese nga KDI, Shefki Kastrati, monitorues nga NDI, Florina Ujupi, monitoruese nga BIRN, Qendresa Mulaj-nga ZAP, Saniqe Berosha, nga OSBE dhe Blerta Behluli- Evsk /Eugja.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 19.04.2016;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe Rreth tij dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**

5. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike;**
6. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015;**
7. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015;**
8. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2015;**
9. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015;**
10. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalet të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 19.04.2016

Kryetari konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe Rreth tij dhe amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Kryetari – Tha se është një projektligj që është punuar me iniciativën e deputetëve dhe unë jam njëri prej tyre që e kam dhënë nënshkrimin për nismën e këtij projektligji, por jam i pakënaqur për draftin që ka ardhur, për arsye se ideja ka qenë që shpenzimet t'i bartë dëmtuesi i ambientit që është Korporata Energjetike dhe jo Qeveria apo nga mjetet buxhetore. Me draftin e propozuar dhe me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është rregulluar që kostoja buxhetore për zonën e rrezikuar të Obiliqit të trajtohet nga buxheti i Kosovës. Kjo shihet edhe në nenin 9, për të cilin ka edhe amendamenti të Komisionit FunkSIONAL ku thuhet se buxhetin për zonën e veçantë e siguron Qeveria e Republikës së Kosovës përmes ndarjes së grantit prej 20% të mjeteve të cilat Qeveria së Kosovës i inkason në emër të eksploatimit të thëngjillit apo tantimës. Kur kemi diskutuar për idenë e këtij ligji, kemi menduar që këtu të forcohet niveli shëndetësor në këtë zonë specifike, kemi menduar që të krijojmë mundësi më të mira për aktivitete sportive në këtë anë. Unë mendojë që në këtë projektligj ka hapësirë të punohet me shumë dhe të rregullohen çështjet buxhetore dhe financiare, dhe do të ishte e nevojshme të formojmë një grup punues, dhe të punojmë bashkërisht me Komisionin FunkSIONAL, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe të propozojmë ndryshimet e nevojshme që ta bëjmë një ligj i cili gjen zbatim dhe është në interes të komunitetit.

Agim Krasniqi – Theksoi se kostoja e vlerësuar për këtë projektligj dhe kostoja reale për zbatimin e tij ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë. Propozimi për shfrytëzimin e 20 % të tantimës kalon 4 milionë euro dhe paraqet një çrregullim në buxhet. Unë mendojë se duhet të gjendet mënyra që bashkërisht me shikuar ligjin dhe me ecur përpara dhe të bëjmë një ligj të zbatueshëm dhe që është në harmoni me ligjin për financat e pushtetit lokal dhe me ligjet e tjera dhe të sigurohemi se do të jetë i zbatueshëm.

Kryetari – Propozoi që Komisioni të caktojë një grup punues të përbërë nga: Naser Osmani dhe Safete Hadergjonaj. Pjesë e grupit punues të ftohen dy përfaqësues të Komisionit FunkSIONAL, zv. ministri i Financave, zv. ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe përfaqësuesi i nismës legislative.

Safete Hadergjonaj - Pajtohem të caktojme një grup punues në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje që nuk bie ndesh me Ligjin për menaxhimin e financave publike, por në të njëjtën kohë të bëjmë edhe një zgjidhje për atë zonë të ndjeshme, në mënyrë që të miratojmë një ligj që është i zbatueshëm, sepse nëse e procedojmë kështu ligjin nuk do të zbatohet.

Bardhyl Meta – Propozoi që grupi punues të ketë parasysh faktin, se jo vetëm në Kosovë, por në krejt botën, kompanitë e mëdha marrin përsipër përgjegjësinë për ndotjen e ambientit. Prandaj edhe në këtë rast duhet vetëdijesim nga KEK-u për përgjegjësinë sociale dhe të ambientit që ka për atë zonë dhe të merret si shembull rasti i SHARRCEM-it, për investimet që ka bërë, që ndër tjera e ka formuar edhe inkubatorin që i ka kushtuar 1.5 milion euro dhe çdo i ri që ka një ide e sponsorizon atë. KEK-u me marrëveshjen që ka me KEDS-in, ka të hyra të sigurta, prandaj duhet të marrë përgjegjësitë që duhet të dalin nga ky ligj.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Vendim

I. Caktohet grupi i punues, për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe Rreth tij dhe amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (në aspektin buxhetore dhe financiar), me këtë përbërje:

1. Naser Osmani – kryesues, dhe
2. Safete Hadërgjonaj, anëtare.

II. Grupi Punues, në takimet për shqyrtimin e projektligjit dhe amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, do të ftojë dy anëtarë të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, zëvendësministrin e Financave, zëvendësministrin për Zhvillim Ekonomik dhe përfaqësuesin e nismës legjislative.

III. Grupi punues e paraqet raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në Komision.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës dhe amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari – Theksoi se kemi të bëjmë me një projektligj që është që një kohë të gjatë në Kuvend. Kam pranuar edhe një letër nga Banka Botërore përmes kryetarit të Kuvendit për këtë projektligj. Kostoja buxhetore e vlerësuar është afro 300.000 euro, por kjo mundet me qenë edhe më e madhe. Miratimi i ligjit buron edhe nga biseda e Brukselit. Ajo që ne mundemi me ndërhyrë është neni 27 që ka të bëjmë me miratimin e buxhetit të Agjencisë dhe të propozojmë që të ndryshohet ky neni, si vijon “Agjencia përgatit dhe menaxhon buxhetin në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë”.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, përmban kosto buxhetore të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 27, ndryshohet si vijon:

Neni 27 Buxheti i Agjencisë

Agjencia përgatit dhe menaxhon buxhetin në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, për Projektligjin Nr. 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
5. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

Agim Krasniqi – Tha se kemi vlerësuar koston buxhetore të projektligjit dhe në draftin që e kemi pranuar ka qenë me kosto shtesë dhe jemi takuar prapë me auditorin dhe i kemi harmonizuar qëndrimet dhe drafti i dytë që është proceduar nuk përmban kosto buxhetore shtesë. Sa i përket amendamenteve të Komisionit Funkcional, ku është propozuar rregullimi i pagës së auditorit të përgjithshëm është e njëjta praktikë sikur me të gjitha agjencitë që duan me rregulluar pagën përmes ligjeve e veçanta.

Safete Hadergjonaj – Tha se tek amendamenti 9 është propozuar që edhe drejtori i administratës të mos jetë shërbyes civil. Unë nuk e di pse mos me e trajtuar me ligjin e shërbimit civil drejtorin e administratës? Po ashtu nuk e shoh të arsyeshme edhe auditorët me u heq prej shërbimit civil.

Agim Krasniqi – Edhe unë mendojë se drejtori i administratës duhet të trajtohet si shërbyes civil.

Kryetari – Sqaroi se për ta hequr drejtorin e administratës, ne duhet të bëjmë një amendament në projektligj dhe të kërkojmë të fshihet amendamenti i Komisionit Funkcional që trajton këtë çështje. Propozoj t'i bëjmë dy amendamente. Dy amendamentet e propozuara nga kryetari janë përkrahur nga Komisioni dhe janë pasqyruar në rekomandimin e nxjerr për këtë pikë të rendit të ditës, në vazhdim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamente në Projektligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si vijon:

Amendamenti 1

Neni 4, pas paragrafit 7, shtohen dy paragrafë të rinj, 8 dhe 9, me tekstin si vijon:

8. Niveli i pagës së Auditorit të Përgjithshëm, caktohet me Ligjin përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë.

9. Deri në miratimin e Ligjit përkatës, që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë, paga e Auditorit të Përgjithshëm, caktohet nga Kuvendi.

Amendamenti 2

Neni 16, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Legjislacioni përkatës për shërbimin civil, nuk zbatohet vetëm për Auditorin e Përgjithshëm, zëvendësauditorin e përgjithshëm, ndihmëauditorët e Përgjithshëm dhe auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa stafi tjetër trajtohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015

Kryetari - Në bazë të nenit 15.2 të Ligjit për Aviacionin Civil, drejtori i Përgjithshëm duhet të përgatisë, të përfundojë dhe t' i sigurojë Bordit, Ministrisë, Qeverisë dhe Kuvendit, një raport gjithëpërfshirës vjetor deri më 31 mars. Raporti është dërguar me kohë dhe është përgatitur mirë teknikisht.

Driton Gjonbalaj - Tha se buxheti i aprovuar për AAC për vitin 2015, ka qenë 924,836 euro. Gjatë vitit ka pasur shkurtime me vendimet përkatëse të Qeverisë dhe buxheti përfundimtar ka qenë 833.210 euro. Gjithashtu kemi pasur edhe një grant nga Komisioni Evropian për projektin e dizajnit të procedurave të fluturimit përmes sinjaleve satelitore. Buxheti i shpenzuar është 824,469 euro, apo shprehur në përqindje 98%. Sa i përket të hyrave gjatë vitit të kaluar AAC ka planifikuar të mbledhë 1.5 milion euro dhe të hyrat e realizuara kanë qenë 1,532,762 euro, apo 2,18% më shumë krahasuar me të hyrat e planifikuara. Të gjitha kategoritë janë shpenzuar në mënyrë optimale jemi përpjekur që të mos tejkalojmë 100% në asnjë kategori. Kemi pasur kursime në disa kategori, si në shpenzimet komunale, për shpenzimet e telefonisë dhe se tash mesatarisht shpenzime të telefonisë fikse për të një punësuar është 3 euro, që ka qenë rekomandim i deputetëve të këtij Komisioni në raportimin e vitit të kaluar.

Besa Gaxherri – Unë e kam lexuar raportin dhe është i përgatitur mirë teknikisht. U raportua se janë ulur shpenzimet për telefon, por konsideroj se ka hapësirë ende për shkurtime, pasi që shpenzimet e telefonisë mobile i keni realizuar 9,903 euro. Po e shoh se keni pasur trajnime dhe ato janë të mirëseardhura, por 60 trajnime brenda viti janë shumë. Kam një pyetje rreth anulimit të fluturimeve, që si rezultat udhëtarët po torturohen dhe dëmtohen, më intereson të dijë ju, si agjenci, a i inspektoni anulimet e fluturimeve për shkaqe të panjohura? Në bazë të raportit shihet se bordi i AAC-së prej pesë anëtarësh nuk ka qenë në funksion prej shtatorit të viti 2013. Kisha dashur me ju pyet: a ju ka penguar bordi në procesin e punës suaj dhe vërtet a ka nevojë me qenë ky bord apo jo?

Driton Gjonbalaj- Sqaroj se shpenzimet e telefonisë mobile janë me të larta se ato fikse, mirëpo ato shumica janë mbushjet për inspektor të terrenit, dhe duke reflektuar shumat monetare që janë parashikuar me udhëzimin e Qeverisë i bie 27,8 euro mesatarisht për individ. Sa i përket anulimit të fluturimeve keni të drejtë, kemi anulime të fluturimit gjatë kohës së dimrit për shkak të kushteve atmosferike, por ka anulime edhe për arsye komerciale. Por Ligji për AAC-në këto përgjegjësi në

mënyrë eksplicite ia jep Ministrisë së Infrastrukturës, të cilët janë përgjegjës për rregullimin ekonomik për transportin ajror, të cilët japin lejet për fluturime ajrore dhe kanë një rregullore për të drejtat e pasagjerëve. Unë e di që kolegët tanë nga Ministria e Infrastrukturës kanë bërë përpjekje të mëdha për identifikimin e njerëzve ta afektuar nga anulimet e fluturimeve dhe të gjithë ata që janë lajmëruar janë kompozuar, por për fat të keq një numër i madh i udhëtarëve ende nuk kërkon apo ankohet që kompanitë tua kompozojnë humbjet monetare.

Besa Gaxherri - A ka mundësi brenda aeroportit me e pasur një zyrë të ministrisë apo të agjencisë ku qytetari shkon dhe e bënë ankesën?

Driton Gjonbalaj - Sqaroi se AAC e ka zyrën në aeroport dhe ajo shfrytëzohet për inspektorët tanë, për pajisjet e inspektimit dhe përgjegjësia jonë është rregullimi teknik i sigurisë të AAC së. Por asnjë pengesë nuk e shoh që edhe ministria të kërkojë një zyrë në aeroport, të ketë një të punësuar permanent i cili është në gjendje të komunikojë drejtpërdrejt me udhëtarët. Sa i përket pyetjes për bordin në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil, nuk ka kompetenca ekzekutive dhe është dëshmuar se AAC mund të funksionojë edhe pa bord. Bordi nuk mund të ndërhyjë në vendimmarrjen e AAC-së. Ai mundet vetëm ta denoncojë performancën e dobët apo shkeljet që mund t'i bëjë AAC, në Kuvend apo te Zyra e auditorit të përgjithshëm.

Besa Gaxherri - Po financimi i bordit a bëhet përmes të hyrave që i keni apo bëhet ndonjë mënyrë tjetër?

Driton Gjonbalaj - Bordi kompensohet përmes financimit të të hyrave, respektivisht buxhetit të AAC-së, dhe forma e kompensimit është e përcaktuar me vendim të Qeverisë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015.

7. Shqyrtimi i Raportit financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015

Kryetari – Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, raportin e ka dërguar me kohë në Kuvend. Fillimisht buxheti ka qenë 36,357.97 euro, ndërkaq buxheti përfundimtarë i agjencisë 289,497.61 euro. Janë shpenzuar 287,557.23 euro apo 99.33%.

Bekim Gimolli - Tha se ashtu siç theksoi kryetari, Agjencia fillimisht ka pasur buxhetin e miratuar prej 36. 357.97 dhe më pas kemi pasur shkurtime buxhetore. Një prej sfidave kryesore ka qenë mungesa e buxhetit në këtë Agjenci për afrimin e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Aktualisht ndihma juridike falas është në pesë zona rajonale, por mungojnë edhe disa qendra rajonale funksionale.

Kryetari – Pyeti përveç kësaj pjese financiare të zyrave rajonale, me çfarë probleme të tjera financiare ballafaqoheni?

Bekim Gimolli – Sfidë tjetër ka qenë çështja e objektit që jemi qira. Ne jemi përpjekur që të kursejmë buxhetin dhe jemi përpjekur që zyrat rajonale të shndërrojmë në objekte publike, siç është rasti i

Prizrenit ku kemi arritur që zyra që ka qenë me qira ta vendosim në kuadër të zyrës rajonale në prokurori.

Besa Gaxherri - Raporti është i imtësuar mirë. Ajo që më ka bërë përshtypje është fakti se buxhetit gjatë viteve 2013-2015 për këtë Agjenci është në rritje për çdo vit, ndërsa në anën tjetër numri i lëndëve ka shkuar duke u zvogëluar. Ju jeni munduar të arsyetoni këtë, ndër tjera, edhe me largimin e donatorëve, por prapë nuk mund të arsyetohet sepse ju jeni konsoliduar tashmë. Pastaj dy komuna që i keni raportuar që nuk ka shërbime për mbrojtje falas, si Ferizaj dhe Gjakova, për mua është e paarsyeshme dhe nuk guxojmë ta lëmë asnjë komunë pa mbështetje, sepse ju e thatë edhe vetë se Kushtetuta ju detyron me afruar këtë shërbim falas. Është dashur t'i rritni kapacitetet që t'i afroni këto shërbime.

Ramadan Gashi - Sqaroi se rënia e lëndëve është për shkak të mbylljes së zyrave. Ne, për momentin, i kemi 5 zyra rajonale. Nëse e shikoni librin e kërkesave të qytetarëve nga komunat e tjera nuk vijnë të kërkojnë ndihmë. Ne u ndihmojmë qytetarëve që i kanë mundësitë shumë të vogla materiale e financiare. Realisht, sipas hulumtimeve që janë bërë, diku 70% e popullatës i plotësojnë kriteret për të marr ndihmë juridike falas. Ne kemi bërë edhe një spot, por edhe kampanjë dhe kemi filluar me punuar edhe shtypjet materiale promovuese përmes donacionit që kemi pranuar nga Norvegjia. Në vitin 2013 më së shumti ka pasur lëndë sepse kanë punuar 13 zyre me kapacitete të plotë. Në vitin 2014 kanë punuar vetëm 6 muaj si vazhdimësi, ndërsa në vitin 2015 kanë punuar me shumë ndërprerje. Është nevojë e domosdoshme të bëhen funksionale zyrat në Ferizaj dhe Gjakovë, por me këto kapacitete që kemi është vështirë të funksionojnë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015.

8. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2015

Kryetari - Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës e ka dërguar me kohë raportin dhe në bazë të dhënave buxhetin fillimisht i ka pasur 2,393,308 euro, por përfundimtari ka qenë 1.812. 248.36 euro.

Idriz Blakaj - Agjencia është themeluar në vitin 2013 dhe momentalisht jemi të pakompletuar. Problem tjetër e kemi punën e rojeve. Dy probleme që auditori i ka theksuar janë mungesa e strategjisë që e kemi bërë kërkesën, por nuk janë ndarë mjetet që dy vjet rresht, dhe dy mjete e mirëmbajtjes së komplekseve memoriale “Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti”. Ministria na ka ndarë me kod te investimet kapitale, por auditori po kërkon me i hedhur në mallra e shërbime se nuk mund të jenë investime kapitale. Jemi detyruar të transferojmë një pjesë të mjeteve prej investimeve kapitale në komunale, për shkak të shpenzimeve të rrymës në pjesën mirëmbajtjes së komplekseve.

Safete Hadergjona – Në raport kemi mospërputhje të shifrave në mes tabelave sa i përket shpenzimeve të prezantuara në shuma monetare dhe në shifra. Duhet të bëhen këto përmirësime të raporti para se të shqyrtohet në Kuvend.

Albana Hajrizi - Agjencia gjatë viti 2015, ka pasur tri ndarje buxhetore. Buxheti fillestar 2,393,308 euro, me rishikim 2,351,527 euro dhe buxhetin final 1,812.48.56 euro, ku ka pasur shkurtime me vendim të Qeverisë. Të shpenzuara kanë qenë 74,519.46 euro, për mallra 40,917.47 euro, për komunal 28,084.49 euro dhe për investime kapitale 1,667,791.71 euro.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2015.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015

Kryetari - Agjencia ka dërguar raportin me kohë në Kuvend dhe në vitin 2015 i janë ndarë buxhet prej 348,883 euro, buxheti me rishikim ishte 348,437 euro, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë në shumë prej 360,754.08 euro. Buxheti i shpenzuar është 348,096.96€ apo 96.49%.

Ruzhdi Jashari – Sqaroi se për paga dhe mëditja, buxheti i shpenzuar është 98.49 %, për mallra dhe shërbime 97.02%, ndërsa shpenzime komunale 18.92%. Agjencia ka bërë racionalizim të shpenzimeve të derivateve, të telefonisë, reprezentacioneve edhe shpenzime të tjera. Në anën tjetër, për shkak të buxhetit të vogël, nuk kemi pasur mundësi me i zhvilluar fushatat e vetëdijshme të kontrolluesit teknik privat, që e kanë obligim ligjor regjistrimin në dosjet e tyre në agjenci. Pastaj pjesa e trajnimit të zyrtarëve të agjencisë që ekspertizë në Kosovë nuk ka edhe janë të domosdoshme aspektet e njohurive relevante Këshillit të Evropës e Bashkimit Evropian dhe të mekanizmave të ndryshëm. Punët me përkushtim të stafit të brendshëm dhe me mbështetje të IPA- së projekteve me ndihmesën e mekanizmave në nivelin lokal dhe atë qendror kemi arritur të kryejmë shumë punë e aktivitete. Kemi zgjidhur problemin e objektit dhe jemi të vendosur në objekt shtetëror.

Kryetari - I pyeti qytetarët e Kosovës a kanë privatësi të garantuara në bazë të të gjeturave tuaja?

Ruzhdi Jashari – Tha se qytetarët e Kosovës kanë privatësinë e tyre të mbrojtur me ligji dhe kanë ku i adresojnë shqetësimet e tyre dhe ne marrim hapat ku ka njohuri edhe ku ka shqetësime të ngritura.

Kryetari – Pyeti pjesa politike e Kosovës a është e rrezikuar në privatësi?

Ruzhdi Jashari – Tha se çështja e përgjimeve në vitin e kaluar është rregulluar me miratimin e Ligjit për përgjimet dhe komisionarit për përgjimet. Ne kemi pasur më se 60 ankesa në agjenci, por e kemi bërë punën tonë, ka pasur ekspert specifik në lidhje me këtë çështje dhe specifikash, i kemi adresuar ato.

Besa Gaxherri – Ne jemi Komisioni i Buxhetit dhe kërkesat buxhetore i aprovojmë për ta pasur mbrojtjen e privatësisë, e kur vjen përfundimi e dimë që nuk kemi privatësi të mbrojtur. Ju duhet të takoheni me institucionet përgjegjëse dhe t'i diskutoni këto çështje sa i përket mbrojtës së privatësisë. Sepse praktika tregon se përgjohemi nga kushdo dhe sido.

Ruzhdi Jashari – Tha se ne kemi bashkëpunim me institucionet vendore dhe me AKI-në, kemi organizuar takime me ekspertë specifikë të përgjimeve dhe këtë vit i kemi gjashtë raste në gjyq. Vitin e kaluar i kemi pasur 15 raste dhe gjithçka që është në kundërshtim me zbatimin e ligjit kemi për të marrë masa.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në ora 12:50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Naser Osmani